

BULETINI INFORMUES

PROGRAMI I PASHTETËSISË JANAR- MARS 2024


Ofrimi i ndihmës juridike falas për personat e cenueshëm të cilëve u mungon identiteti ligjor mbetet qëllimi përfundimtar i Programit për të Drejtat Civile Kosovë (CRPK). Duke mundësuar qasje të informuar në procedurat administrative dhe gjyqësore, ndryshime pozitive sillen në jetën e njerëzve ligjërisht të padukshëm.

PËRGJIGJE NEVOJAVE TË PERSONAVE NË RREZIK TË PA SHTETËSISË/PA SHTETËSI JAN-MARS 2024



- 144 individë të **KONTAKTUAR**
- 29 të identifikuar në **NEVOJË PËR NDIHMË JURIDIKE**
- 30 kanë përfituar nga **NDIHMA JURIDIKE FALAS**
- 2 individë të **PËRFAQËSUAR NË PROCEDURË GJYQËSORE**
- 2 **SESIONE VETËDIJESUESE** të mbajtura me popullsinë e afektuar dhe autoritetet.

DEMOGRAFIA E INDIVIDËVE TË ASISTUAR JANAR - MARS 2024





© 2024 CRPK

Sesioni i vetëdijesimit i mbajtur në Viti

NGRITJA E KAPACITETEVE TË INSTITUCIONEVE DHE REAGIMI

Integrimi gjithëpërfshirës është një nga synimet tona më të mëdha. Nëpërmjet mbështetjes së UNHCR Kosovo dhe partneritetit të sukseshëm me Departamentin për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRRPIF)/MPB, kemi mundësuar një kontakt të drejtpërdrejtë ndërmjet personave me status të njohur juridikisht si dhe autoriteteve nga departamente të ndryshme komunale, përfshirë DRRPIF, Zyra komunale për Komunitete dhe Kthim, Zyra e Punësimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë e Komunes së Vitisë.

Në frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, sesioni për herë të parë u mundësoi këtyre individëve të shprehin shqetësimet e tyre për qasjen në të drejtat dhe shërbimet, duke ndarë përvojat dhe sfidat e tyre në qasjen në të drejta dhe shërbime thelbësore. Reagimet nga autoritetet përkatëse ishin konstruktive, duke pranuar shqetësimet e ngritura dhe duke u angazhuar për të punuar drejt zgjidhjeve.

Ky takim shënon një hap pozitiv drejt gjithëpërfshirjes së personave pa shtetësi, duke theksuar rëndësinë e komunikimit të hapur ndërmjet autoriteteve dhe personave të prekur. Është një kujtesë e fuqishme që kur dëgjohen zërat, ndryshimi është i mundur.



© 2024 CRPK

Në përpjekjet tona për të trajtuar regjistrimin e mëvonshëm të lindjeve, bashkuam forcat me institucionet komunale dhe UNHCR Kosovo ku dhe organizuam një aktivitet sensibilizues në komunën e Fushë Kosovës.

Pjesëmarrësit ndanë sfidat e tyre me situatat ekonomike të vështira, duke theksuar nevojën jetike për ndihmë ligjore, veçanërisht për fëmijët dhe të rriturit e pargjistruar.

Ne jemi të përkushtuar të vazhdojmë të ofrojmë ndihmë ligjore falas për ata që kanë nevojë dhe të punojmë me autoritetet për të krijuar një qasje sistemike për identifikimin dhe ndihmën e individëve të pargjistruar.

Ky aktivitet shënon përparim në nxitjen e përfshirjes, duke siguruar të drejtën e identitetit për të gjithë. Udhëtimi vazhdon me bashkëpunim për të mos lënë askënd pas.

BASHKËPUNIMI ME AKTERËT RELEVANT

Duke punuar së bashku me akterët përkatës, ne po avokojmë për të drejtën e çdo individi për një identitet ligjor, një hap kyç në qasjen ndaj të drejtave themelore të njeriut.

Në Mars, kishim një takim të frytshëm me Qendrën për Punë Sociale (QPS) në komunën e Klinës, duke u përqendruar në rëndësinë e koordinimit të aktiviteteve për të parandaluar dhe reduktuar pashtetësinë.

Një pjesë e rëndësishme e bisedës sonë theksoi rolin e QPS-së në mbështetjen e fëmijëve të pargjistruar me regjistrimin e lindjeve të tyre dhe pajisjen me dokumentacionin e gjendjes civile.



© 2024 CRPK



© 2024 CRPK

XH.B gjatë aplikimit për leje qendrim të përkohshëm

BASHKËPUNIM I NGUSHTË ME INDIVIDËT NË NEVOJË

CRPK është e hapur ndaj kërkesave për ndihmë juridike falas nga komunitetet e cenushme që kanë nevojë për një identitet ligjor, të cilat nuk mund t'i zgjidhin vetë për shkak të mungesës së një informacioni adekuat për procedurat, kompleksitetin e procedurave, nevojën për mbështetje ligjore dhe mungesën e disponueshmërisë së dokumentacion evidentues.

CRPK ka ofruar mbështetje për 3 individë në nevojë për vendosjen e statusit ligjor. Të gjithë ata, me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë pajisur me letërnjoftime të përkohshme të qëndrimit që u mundëson qasje në të drejta dhe shërbime.

Në një hap të rëndësishëm drejt adresimit të pashtetësisë, CRPK ka përfunduar përkthimin e dy dokumenteve kryesore në shqip, serbisht, anglisht dhe arabisht. Këto dokumente, "*Fletëpalosja informative për procedurën e përcaktimit të statusit pashtetësi në Kosovë*" dhe "*Broshura informative për personat pa shtetësi në Kosovë - Njihni të drejtat dhe obligimet e juaja*", janë krijuar për të ofruar informacion thelbësor mbi procedurat për përcaktimin e pashtetësisë dhe për të përshkruar të drejtat dhe obligimet e individëve pa shtetësi.

Kjo nismë siguron që një audiencë më e gjerë mund të ketë qasje në informacione kritike, duke mbështetur kështu nevojat e individëve dhe komuniteteve të prekura nga pashtetësia në Kosovë. Dokumentet tani janë të disponueshme në faqen tonë të ndihmës, duke rritur aksesueshmërinë dhe dobinë e tyre. Kjo përpjekje është pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm të CRPK-së për të ofruar burime dhe mbështetje të vlefshme për ata që janë të prekur nga çështjet e pashtetësisë.

[Lexo më shumë](#)

Na Kontakti



+383 (0) 38 243 -610



Rr. LORENC ANTONI, NO.15, 10000 - PRISHTINË



civilrightsprogramkosovo



www.crpkosovo.org



*Skani kodin QR
për më shumë
informacion*

